VENDIM
Nr.639, datë 29.12.1999

Për miratimin e projektit "përmirësimi i asistencës shëndetësore në situata emergjente në Shqipëri, krijimi i një rrjeti informativ dhe komunikimi

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen traktave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e alokimit të shumës grant prej 1 200 000 000 liretash, nga fondi i emergjencës prej 4 miliardë liretash, dhënë nga qeveria italiane për qeverinë shqiptare në vitin 1997.shumës grant prej 1 200 000 000 liretash, nga fondi i emergjencës prej 4 miliardë liretash, dhënë nga qeveria italiane për qeverinë shqiptare në vitin 1997.

2.Miratimin e projektit "Përmirësimi i asistencës shëndetësore në situata emergjente në Shqipëri, krijimi i një rrjeti informativ dhe komunikimi", dhe marrëveshjen përkatëse.

3.Miratimin e kontributit prej 27 970 000 lekësh, të qeverisë së republikës së Shqipërisë në projekt, si kosto lokale e tij për përballimin e taksave doganore dhe detyrimeve të tjera fiskale.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Ilir Meta